

LIGJ
Nr. 65/2017

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK PËR
ZBATIMIN E PROJEKTIT “ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I INTEGRUAR I RAJONIT
BREGDETAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin teknik për zbatimin e projektit “Zhvillimi i qëndrueshëm i integruar i rajonit bregdetar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.4.2017

Shpallur me dekreten nr. 10272, datë 4.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Ambasadori
i Republikës Federale të Gjermanisë
Numri i dosjes: Wi 445 T/Z 125
Tiranë, më 26 Shtator 2016

Zoti Ministër,

Kam nderin, që në emër të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, duke ju referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 si dhe në zbatim të marrëveshjes mbi Bashkëpunimin Teknik të datës 21 tetor 1988, t’ju propozoj marrëveshjen e mëposhtme mbi Bashkëpunimin Teknik :

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të mbështesin së bashku projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm i integruar i rajonit bregdetar jugor”, nëse nga shqyrtimi përkatës rezulton se ky projekt vlen për t’u mbështetur.

2. Projekti në fjalë ka si qëllim të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë.

3. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin në fjalë me shpenzimet e saj, kontribute personeli dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi në vlerë të përgjithshme prej gjithsej 1 000 000 euro (me fjalë: një milion euro). Ajo do të ngarkojë me zbatimin e projektit Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit; GIZ).

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton një planifikim të vetin buxhetor, ku shpenzimet e ndryshme klasifikohen në zëra më vete, që të sigurojë zbatimin e vazhdueshëm të projektit, dhe kujdeset, që institucioni, i cili do të ngarkohet nga ai me zbatimin e projektit, do të kryejë shërbimet e nevojshme për projektin e lartpërmendur.

5. Hollësitat e projektit dhe të shërbimeve dhe detyrimeve, që duhen të kryhen, do të përcaktohen në një

kontratë zbatimi dhe eventualisht edhe financimi, e cila do të lidhet ndërmjet GIZ-it dhe institucionit, që do të ngarkohet nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë me zbatimin e projektit. Kontrata do t'u nënshtrohet dispozitave ligjore, që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

6. Nëse ky projekt nuk zbatohet ose zbatohet vetëm pjesërisht, ai mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse dy Qeveritë bien dakort për këtë.

7. Fondet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të premtuara për këtë projekt do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se kontrata e zbatimit dhe eventualisht e financimit e përmendur në pikën 5 nuk lidhet brenda një afati prej gjashtë vitesh pas vitit të premtimit. Për fondet e premtuara për këtë projekt, ky afat – pavarësisht nga rregullimi i përmendur në pikën 6 – do të mbarojë më datë 31 dhjetor 2022.

8. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përjashton materialet, automjetet, mallrat dhe pajisjet, si dhe pjesët e këmbimit të lëvruara në kuadër të projektit me porosi dhe me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë nga detyrimet tarifore për licensat, doganat, taksat e portit, të importit dhe të eksportit dhe nga taksa të tjera publike sikurse edhe nga pagesat për magazinim, dhe garanton, që materialet të zhdoganohen pa vonësë.

9. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton GIZ-in nga të gjitha taksat dhe tatimet publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë nga lidhja dhe përmbushja e kontratës së zbatimit dhe eventualisht të financimit të përmendur në pikën 5.

10. Përveç kësaj edhe për këtë marrëveshje janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së lartpërmendur të datës 21 tetor 1988 ndërmjet dy Qeverive tona mbi Bashkëpunimin Teknik.

11. Kjo marrëveshje lidhet në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.

Në qoftë se Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë deklarohet dakord me propozimet e bëra në pikat 1 deri 11, atëherë kjo notë dhe nota e përgjigjes së Shkëlqesisë Suaj, në të cilën shprehet miratimi i Qeverisë Suaj, do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy Qeverive tona, e cila do të hyjë në fuqi në datën e notës Suaj të përgjigjes.

Pranoni, zoti Ministër, sigurimet e konsideratës sime më të lartë.

Shkëlqesisë së Tij
Ministrit të Punëve të Jashtme
të Republikës së Shqipërisë
Zotit Ditimir Bushati
Tiranë